



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PERGJITHESHME E DOGANAVE
Departamenti Teknik
Drejtoria e Procedurave Doganore dhe Borxhit

Adresa: Rruga e Durresit, Laprake- Tirane 14394

Tel 243920, 256547

UDHEZIM

Nr. 03, date 11.11. 2009.

Mbi zbatimin praktik te procedurave te miratimit dhe funksionimit te perfaqesimit te drejtperdrejte ne dogane.

Ne zbatim te nenit 17 dhe 89 te Ligjit nr.8449, date 27.01.1999 "Per Kodin Doganor te Republikes se Shqiperise";

Me qellim percaktimin e sakte te procedurave qe zbatohen lidhur me perfaqesimin e drejtperdrejte ne dogane, Drejtori i Pergjithshem i Doganave,

U D H E Z O N:

Perkuftizime te pergjithshme:

1. Per qellime te ketij udhezuesi;

a) "*Perfaqesim i drejtperdrejte*" – eshte nje prej llojeve te perfaqesimit, permes te cilit, i perfaquesuari mund te caktoje per te vepruar ne emer dhe per llogari te tij, nje person tjeter ne cilesine e perfaquesuesit, me qellim kryerjen e veprimeve dhe permbushjen e formaliteteve te nevojshme te parashikuara nga legislacioni doganor ~~ndertet me derri i tij i kundar te dogane.~~.

b) "*I perfaquesuar*" - do te thote cdo person fizik ose juridik ne emer e per llogari te te cilit paraqiten mallrat ne dogane dhe per te cilat kerkohet zbatimi i formaliteteve doganore.

✓ “*Perfaquesues*” – do te quhet personi qe ka te drejte per te vepruar ne emer dhe per llogari te te perfaquesuarit, i autorizuar nga ky i fundit dhe i njojur nga autoritetet doganore.

Procedurat qe zbatohen per miratimin e personave qe veprojne si perfaquesues te drejtperdrejte.

2. Çdo person fizik ose juridik, i regjistruar per aktivitet tregtar dhe qe kryen veprimitari import-eksporti te mallrave ne dhe nga territori doganor i Republikes se Shqiperise, mund te caktoje perfaquesues te vetin per marredheniet me autoritetet doganore.

3. Kriteret qe duhet te plotesoje personi qe do te veproje si perfaquesues jane:

- Te kete zotesi juridike dhe zotesi per te vepruar si dhe te jetë person i vendosur ne territorin e Republikes se Shqiperise (me perjashtim te rasteve qe parashikon neni 89 pikat 2/b dhe 3 te Kodit Doganor).
- Te zoteroje një marreveshje kontraktuale punesimi.
- Te zoteroje një “Prokure perfaqsimi” si dokument qe merr force ligjore nese nenshkruhet perpara një noteri. Ne kete dokument duhet te percaktohen detyrat e te drejtat e perfaquesuesit si dhe afati i vlefshmerise se dokumentit.
- Te paraqese vertetim nga Gjykata e Rethit Gjyqesor dhe nga organi i Prokurorise qe nuk eshte ne ndjekje penale.

5. Kriteret e përmendura më lart, parashtohen ne kerkesen per miratim (njojhe) te personit qe do te veproje si perfaquesues i drejtperdrejte. Kesaj kerkese i bashkangjitet i gjithe dokumentacioni i nevojshem qe verteton plotesimin e kritereve.

6. Kerkesa per miratimin e perfaquesuesit te drejtperdrejte, duhet te hartohet nga personi qe kerkon te perfaquesohet ne dogane, sipas Aneksit 1,bashkangjitur. Kjo kerkese duhet te paraqitet prane Drejtorisë te Pergjithshme te Doganave, ne te cilën, perfaquesuesi nenshkruan, personalisht, ne prezence te punonjesit te ngarkuar me shqyrtimin e kerkeses duke bere te mundur depozitim i firmes per njojhe dhe krahasimin e saj me nenshkrimin ne dokumentin e identifikimit (Karten e Identitetit).

7. Drejtoria e Pergjithshme e Doganave (Drejtoria e Procedurave Doganore dhe Borxhit) pasi shqyrton dokumentacionin, perqatit per miratim autorizimin, sipas aneksit Nr.2 bashkangjitur.

Pas miratimit te Autorizimit nga Drejtori i Pergjithshem i Doganave, Drejtoria e Procedurave Doganore dhe Borxhit kryen veprimet e regjistrimit ne sistemin

Asycuda World, te te dhenave qe lidhen me personin qe do te veproje si perfaquesues i drejperdrejte.

Per qellime te identifikimit, numri i Autorizimit, me 3 (tre) shifra dhe me germen "D" ne fund, do te perdoret, si kod individual i perdoruesit te sistemit, per nevoja te deklarimit ne dogane (p.sh. kodi 000D).

Rregulla te per gjithshme.

8. Ne te gjitha rastet, personi i autorizuar si perfaquesues i drejperdrejte, pavaresisht se vepron ne emer dhe per llogari te te perfaquesuarit duhet:

- te paraqese Autorizimin qe i jep mundesine te perfaqesoje ne menyre te drejperdrejte se bashku me prokuren e perfaqesimit dhe dokumentin e identifikimit (karte identiteti ose Pasporte).
- te nenshkruaje ne prezence te doganierit pranues, deklaratene doganore (DAV).

9. Ne rastet kur i perfaquesuari, vendos te mos perfaqesohet me nga perfaquesuesi per te cilin eshte leshuar nje autorizim nga ana e autoriteteve doganore, eshte i detyruar te njoftoje menjehere, me shkrim, Drejtorine e Pergjithshme te Doganave (Drejtorine e Procedurave Doganore dhe Borxhit) ne menyre qe, kjo e fundit, te mundesoje bllokimin ne sistem, te te drejtave te perfaquesuesit.

10. Ky Udhezim hyn ne fuqi menjehere.

Endri PEMA

DREJTORI PER GJITHSHEM



Kerkese per miratim te perfaqesimit te drejtperdrejte.

Kerkuesi (emri, adresa, NIPT-i):

Ne cilesine e personit qe kerkon te perfaqesohet per veprimet qe lidhen me plotesimin e formaliteteve te deklarimit ne dogane kemi caktuar te perfaqesohemi ne menyre te drejtperdrejte nga:

Z/Zj. _____ nr.ID _____

Per deklarim te mallrave per;

Tranzit

Vendosje ne qarkullim te lire apo regime ekonomike

Eksport

Prane autoriteteteve doganore te ZYRES DOGANORE _____

KERKUESI

(nenshkrimi, vula)

Per plotesim nga autoritetet doganore miratuese

Dokumentacioni bashkangjitur:

- Dokument identifikimi: Pasaporte Karte Identiteti
- Kontrate pune
- Prokure e posacme perfaqesimi
- Vertetim nga autoritetet doganore
- Vertetim nga autoritetet tatimore
- Vertetim nga Gjykata
- Vertetim nga Prokuroria

Depozitimi i nenshkrimit nga personi :

Emer, mbiemer, nenshkrim:

Konfirmimi nga punonjesi i DPD:

Emer, mbiemer, nenshkrim:



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Ministria e Financave

DREJTORIA E PERGJITHESHME E DOGANAVE

AUTORIZIM Nr. 000 D

Ne mbeshtetje te Ligjit nr. 8449 date 27.01.1999 per Kodin Doganor te Republikes se
Shqiperise neni 7, autorizojme Z./Znj _____ te kryeje perfaqsimin e drejtperdrejte per
llogari Shoqerise " _____" me nr NIPT _____.

TIRANE me ____ / ____

Nr. _____ I ROT.

DREJTOR I PERGJITHSHEM